



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 20/06/2022 Ref.: 833/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 99-të, të mbajtur më 13.05.2022 dhe 23.05.2022, mori:

#### V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit i Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, për periudhën pesë vjeçare, 1 tetor 2022 – 30 shtator 2027:
  1. *Juridik i Përgjithshëm, LLB*, 240 ECTS, maksimumi 180 studentë për vit akademik.
- II. Riakreditohet programi i studimit i Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, për periudhën tri vjeçare, 1 tetor 2022 – 30 shtator 2025:
  1. *Administrim Biznesi, BSc*, 180 ECTS, maksimumi 150 studentë për vit akademik.
- III. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren që deri më datë 15.11.2022 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## A r s y e t i m i

I. Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programit të studimit me stafin akademik si në tabelën e mëposhtme:

<i>Nr.</i>	<i>Programi i studimit</i>	<i>Bartësit e programit</i>
1.	Juridik i Përgjithshëm, LLB Ri akreditim	Armend Podvorica Berat Aqifi Halim Bajraktari Safet Krasniqi Enver Bucaj Dardan Vuniqi Kadri Kryeziu Muharem Faiku Arif Riza Eqrem Zenelaj
2.	Administrim Biznesi, BSc Ri akreditim	Behxhet Brajshori Floriqe Govori Nerimane Bajraktari Anera Alishani-Musliu

Çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit, duhet të raportohet dhe arsyetohet në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar duhet të aprovohet nga KSHC

AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit.

Vizita është organizuar më 07.03.2022, me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Johan Falterbaum, Jana Fiserova, Christoph Back dhe Christopher Bohlens.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit, dhe për secilin program, bazuar në fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit *Juridik i Përgjithshëm, LLB.*, 240 ECTS, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht katër (4) standarde dhe substancialisht tri (3) standarde.
2. Për programin e studimit *Administrim Biznesi, BSc*, 180 ECTS, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht një (1) standard, substancialisht pesë (5) standarde dhe pjesërisht një (1) standard.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 99 të mbajtur më 13.05.2022 dhe 23.05.2022 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

  
Prof. Ass. Dr. Hasnija Raza  
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë



Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.